Kronikë

Lezhë/ U kapën në flagrancë gjatë natës duke kryer gjueti të paligjshme, nis hetimi për dy persona

Policia e Lezhës ka nisur hetimet për dy persona pasi u kapën gjatë natës duke kryer gjueti të paligjshme në Ishull Lezhë.

Fisheket e sekuestruar

Redaksia
16 Tetor, 13:09 | **Përditësimi: 16 Tetor, 13:15**

Share

Policia e Lezhës ka nisur hetimet për dy persona pasi u kapën gjatë natës duke kryer gjueti të paligjshme në Ishull Lezhë.

Nga kontrollet e kryera në automjetin e tyre blutë gjetën 20 shpendë të vrarë me armë gjahu, si dhe disa fishekë për armë gjahu.

Njoftimi i policisë:

LEXO EDHE:
Protesta/ Dhjetëra makina me flamuj kuqezi dhe simbole të UÇK-së drejt Tiranës, qytetarët e Kosovës dynden drejt kryeqytetit

Shërbimet e Komisariatit të Policisë Lezhë, bazuar në planin e masave të hartuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Lezhë, për parandalimin dhe goditjen e rasteve të gjuetisë së paligjshme, kanë kryer kontrolle në zona të ndryshme të qarkut Lezhë.

Gjatë kontrolleve, në Ishull Lezhë, janë kapur në flagrancë 2 shtetas që po kryenin gjueti të paligjshme në këtë zonë. Në vendin ku u kapën këta shtetas, u konstatua dhe automjeti i tyre, në të cilin, gjatë kontrollit u gjetën 20 shpendë të vrarë me armë gjahu, si dhe disa fishekë për armë gjahu.

Në përfundim të veprimeve për këtë rast, specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Lezhë referuan materialet në Prokurori, ku filloi procedimi në gjendje të lirë për shtetasit A. P, 28 vjeç, banues në Divjakë, dhe M. H., 31 vjeç, banues në Tiranë.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë së Lezhës, për veprime të mëtejshme, për veprën penale "Dëmtimi i specieve të vogla të florës dhe faunës së egër."

Xh.K/Shqiptarja.com

TAG: gjueti e paligjshme | Lezhe

Komento

Komente

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës: 17 Tetor, 08:11
Përplasja Kurti-Rama për protestën e UÇK-së, kujt i jepni të drejtë?

Edi Ramës | Albin Kurtit | Asnjërit

Lajme të tjera

Lezhë/ Punonjësi ndërroi jetë pasi u rrëzua nga lartësia e pallatit, policia shpall në kërkim drejtuesin teknik të firmës
17 Tetor, 09:43

Kurbin/ Iu gjet 7 kg kanabis në banesë, pranga 62-vjeçarit! E kishte fshehur në një fuçi uji (EMRI+VIDEO)
17 Tetor, 09:25

Lezhë/ Kapet në kohë rekord autori i dyshuar për vjedhjen e një automjeti (EMRI+VIDEO)
16 Tetor, 22:21

Lezhë/ Aksident në një kantier ndërtimi në Shëngjin! Punëtori bie nga lartësia, humb jetën
16 Tetor, 17:30

Si përdoret shega në gatimin e rizotos e spagetit? Shefat më në zë të Lezhës tregojnë sekretin e recetave teksa gatuajnë në sheshin "Gjergj Kastrioti" (VIDEO)
Elvis Hila
16 Tetor, 16:16

Minatorët e Spaçit në Mirditë në ditën e 8-të protestës! Kompania nuk njeh sindikatën, asnjë negociatë për pagat
16 Tetor, 14:26

Lezhë/ Gjyqi për vrasjen e vitit 1997, arrestohen burrë e grua, policia: Dhanë dëshmi të rreme në gjykatë
15 Tetor, 14:43

Prodhues nga Kalabria në Mirditë: Investime të reja për përpunimin e mishit dhe bulmetit! Madeo: Synojmë certifikimin e produkteve
Elvis Hila
15 Tetor, 13:53

Minatorët e Spaçit vijojnë protestën, kërkojnë kushte më të mira pune dhe paga më të larta (VIDEO)
15 Tetor, 12:18



Operacioni 'Processing'/ Sekuestrohen 40 kg kanabis pranë një banese në Mirditë, arrestohen tre persona, dy prej tyre vëllezër (EMRAT+VIDEO)
15 Tetor, 09:37

Shpërthejnë dy bombula gazi në një lokal në Ishull-Lezhë, shkaktohen dëme materiale (VIDEO)
Elvis Hila
14 Tetor, 19:52

Vijon protesta e minatorëve në Spaç, 10 të vënë nën hetim! Akuzohen për kundërshtim të policisë dhe bllokim të qarkullimit (VIDEO)
Elvis Hila
14 Tetor, 12:14

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje